

VENDIM
Nr. 68, datë 27.1.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 786, DATË 19.11.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I MUZEUT TË BASHKËJETESËS”, MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 1/2014, TË KOMITETIT SHTETËROR TË MUZEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 4, e vendimit nr. 786, datë 19.11.2014, të Këshillit të Ministrave ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 173 091 780 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekësh, të përballohet nga llogaria e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve.”.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama